

VENDIM
Nr. 119, datë 18.3.2000

PËR PROCEDURAT E PRIVATIZIMIT ME ANKAND TË PAKETAVE SHTETËRORE TË
AKSIONEVE TË SHOQËRIVE TREGTARE, QË VEPROJNË NË SEKTORËT
JOSTRATEGJIKË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 7, të ligjit nr.8334, datë 23. 4. 1998, "Për privatizimin e shoqërive tregtare, që veprojnë në sektorët jostrategjikë", me propozimin e ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I :

1. Ministri i Ekonomisë Publike dhe Privatizimit nxjerr urdhrin për fillimin e procedurave të privatizimit me ankand të paketave shtetërore të aksioneve të shoqërive tregtare, që veprojnë në sektorin jostrategjik.

2. Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, brenda 5 ditëve nga dita e nxjerrjes së urdhrin të ministrit, i dërgon Agjencisë Kombëtare të Privatizimit dokumentacionin për privatizimin e shoqërisë, që shërben për të gjitha format e privatizimit sipas këtij vendimi, në origjinal ose të njehsuar me të, i cili përmban:

a) Urdhrin e ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit për fillimin e procedurave të privatizimit.

b) Aktin e themelimit dhe statutin e shoqërisë.

c) Vendimin e regjistrimit të shoqërisë si person juridik në gjykatë me ndryshimet e bëra në të.

ç) Bilancin e shoqërisë.

d) Raportin e ekspertit kontabël.

dh) Genplanin, planvendosjen e shoqërisë, të lëshuar nga zyra e urbanistikës së qytetit/ rrethit përkatës.

e) Aktvlerësimin e truallit të shoqërisë.

ë) Vërtetimin nga Qendra e regjistrimit të aksioneve për regjistrimin e shoqërisë që privatizohet, kur shoqëria ka mbi 50 aksionerë.

3. Agjencia Kombëtare e Privatizimit, brenda 10 ditëve nga mbërritja e dokumentacionit, shqyrton rregullsinë e tij. Kur në dokumentacionin e dërguar vërehen parregullsi të kërkesave të pikës 2 të këtij vendimi, Agjencia Kombëtare e Privatizimit e kthen atë në Ministrinë e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit për plotësim.

4. Me Publikimin e shoqërisë për privatizim, asaj i ndalohet të bëjë çdo ndryshim kapitali, të marrë hua apo kredi.

I. Procedurat për përcaktimin e formulës së privatizimit.

A. Publikimi.

1. Pas shqyrtimit të dokumentacionit, AKP-ja fillon menjëherë publikimin. Periudha e publikimit zgjat 30 ditë dhe bëhet në tri gazeta me qarkullim kombëtar nga tri herë në secilën gazetë.

2. Publikimi përmban këta elemente:

- Emrin e shoqërisë tregtare;
- Selinë e shoqërisë;
- Kapitalin themeltar dhe numrin e aksioneve të shoqërisë tregtare;
- Sipërfaqen e truallit të shoqërisë, të lirë dhe të mbuluar;
- Objektin e veprimtarisë;
- Afatin e regjistrimit dhe llojin e dokumenteve, që punonjësit e shoqërisë duhet të dorëzojnë pranë shoqërisë;
- Afatin e regjistrimit dhe llojin e dokumenteve, që punonjësit e shoqërisë duhet të dorëzojnë në Agjencinë Kombëtare të Privatizimit;

- Afatin e regjistrimit dhe llojin e dokumenteve që ish-pronarët e truallit duhet të dorëzojnë në Agjencinë Kombëtare të Privatizimit.
3. Brenda periudhës së publikimit në gazetën me qarkullim kombëtar, degët e Agjencisë Kombëtare të Privatizimit në rrethe vendosin afishe, me të dhënat e publikuara për shoqëritë që privatizohen, pranë shoqërive që ndodhen në rrethin përkatës.
 4. Në fund të periudhës së publikimit Agjencia Kombëtare e Privatizimit dhe degët e kësaj agjencie në rrethe mbajnë një procesverbal për vendosjen e pranë shoqërive të afisheve, me të dhënat e publikuara dhe mbylljen e publikimit.

B. Procedurat e llogaritjes së paketës së aksioneve për punonjësit e shoqërisë.

1. Punonjësit e shoqërisë, brenda 10 ditëve nga dita e parë e publikimit nga Agjencia Kombëtare e Privatizimit, duhet të paraqesin pranë shoqërisë çertifikatën e gjendjes familjare, lëshuar nga zyra e gjendjes civile pas datës së publikimit, me anë të së cilës përcaktohen anëtarët që përfitojnë bono privatizimi.
 2. Shoqëria lëshon vërtetimin për identitetin e punonjësit, periudhën e punësimit ose datën e daljes së tij në asistencë, për trajtimin me pagesë papunësie.
 3. Shoqëria, në bazë të këtij dokumentacioni, brenda 25 ditëve nga dita e publikimit për fillimin e procedurës së privatizimit, i dërgon Agjencisë Kombëtare të Privatizimit të dhënat, sipas formularëve të përcaktuar prej kësaj të fundit.
 4. Brenda 30 ditëve, nga data e publikimit të radhës, punonjësit e shoqërisë bëjnë regjistrimin e kërkesave për zotërim aksionesh në këmbim të bonove të privatizimit në Agjencinë Kombëtare të Privatizimit, në bazë të përcaktimeve të pikave 1, 2 dhe 3, të shkronjës "B", të këtij vendimi.
 5. Punonjësit e shoqërisë kanë të drejtë të shkëmbejnë, me vlerë nominale, bonot e privatizimit, të tyre, dhe ato të familjes, në aksione të shoqërisë. Pjesëmarrja e punonjësve në aksione të shoqërisë, do të llogaritet si raport ndërmjet vlerës së bonove familjare të privatizimit, të dorëzuara, të cilat ata i zotërojnë sipas legjislacionit në fuqi (Dekreti nr.1030, datë 1. 11.1996, ndryshuar me akte të tjera ligjore), në raport me kapitalin themeltar të shoqërisë. Përqindja e aksioneve të tyre mbetet e pandryshuar në raport me pjesën tjetër, pavarësisht nga rezultatet e ankandit.
 6. Punonjës të shoqërisë janë punonjësit aktualë dhe ata të trajtuar me asistencë, sipas ligjit nr.7521, datë 30. 10.1991, "Për përkrahjen sociale për personat që dalin pa punë nga zbatimi i reformës ekonomike".
- Për punonjësit e asistencës ruhet e drejta që nga publikimi i parë për privatizim.

C. Procedurat për llogaritjen e paketës së aksioneve për ish-pronarët e truallit.

1. Ish-pronarët e truallit, si subjekte kërkuese, në dallim nga subjektet e tjera kërkuese, në mbështetje të ligjit nr.7698, datë 15. 4. 1993, "Për kthimin dhe kompesimin e pronave ish-pronarëve ndryshuar", ndryshuar me akte të tjera ligjore, kanë të drejtë të marrin aksione të shoqërisë që privatizohet, në bazë të sipërfaqes së truallit, të përcaktuar në vendimin e Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të pronave ish-pronarëve, brenda kufizimit të shoqërisë dhe çmimit të truallit, përcaktuar sipas vendimit nr.312, datë 30.6.1994, të Këshillit të Ministrave.
2. Pjesëmarrja në aksione të shoqërisë për ish-pronarët e truallit do të llogaritet si raport ndërmjet vlerës së truallit të llogaritur për ish-pronarët, sipas kriterëve të mësipërme, në raport me kapitalin themeltar të shoqërisë.
3. Ish-pronari i truallit, për vlerën e truallit si pjesë e kapitalit themeltar të shoqërisë, nuk merr pjesë në ankandin e aksioneve. Ai zotëron një përqindje të caktuar të aksioneve, e cila mbetet e pandryshuar, në raport me pjesën tjetër të kapitalit të shoqërisë, pavarësisht nga rezultatet e ankandit.
4. Brenda 30 ditëve nga data e parë e publikimit, ish-pronarët e truallit duhet të paraqesin në AKP, në origjinal:
 - kërkesën me shkrim për zotërim aksionesh në kapitalin e shoqërisë që privatizohet, në përpjesëtim me vlerën e truallit që atij i njihet nga vendimi përkatës i Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të pronave të ish-pronarëve.

- vendimin e Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të pronave ish-pronarëve, së bashku me gentplanin e hartuar nga ky komision.
- dëshminë e trashëgimisë dhe prokurën e përfaqësimit të posaçme.
- një vërtetim nga Komisioni i Kthimit e Kompensimit të pronave të ish-pronarëve, ku të konfirmohet se për sipërfaqen e truallit, ish-pronë e tij, që ish-pronari kërkon të kompensohet me aksione në shoqërinë përkatëse nuk është kompensuar më parë me njërin nga format që njeh ligji.

D. Formula e privatizimit

1. Agjencia Kombëtare e Privatizimit, në bazë të dokumentacionit të paraqitur nga degët e saj në rrethe dhe ish-pronarët e truallit, brenda 25 ditëve nga data e fundit e publikimit dhe mbyllja e kërkesave, bën sistemin e tij dhe kryen llogaritjet për pjesët e kapitalit të shoqërisë që përbëjnë paketat e aksioneve për punonjësit e shoqërisë dhe ish-pronarët e truallit.

2. Në përfundim të llogaritjeve Agjencia Kombëtare e Privatizimit nxjerr:

- rezultatin e kërkesës për aksione të shoqërisë për secilin punonjës dhe për çdo anëtar të familjes së tyre, në këmbim të bonove të privatizimit.
- rezultatin e porositjes së aksioneve të shoqërisë për ish-pronarët e truallit.
- rezultatin përfundimtar të llogaritjeve për pjesën e kapitalit themeltar të shoqërisë, që përbën paketën e aksioneve për punonjësit e shoqërisë e për ish-pronarët e truallit, të cilin ia dërgon Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit.

1. Ministri i Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, brenda 10 ditëve pas marrjes së rezultatit përfundimtar nga AKP-ja, përcakton formulën e privatizimit, nxjerr urdhërin përkatës dhe e përcjell në AKP.

2. Në çdo rast, pjesë e urdhërit të ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit janë edhe të dhënat për shitjen e paketës së aksioneve, në përqindje, vlera nominale e paketës së aksioneve, numri i aksioneve që shiten dhe mënyra e pagesës së vlerës së paketës së aksioneve.

3. Në përcaktimin e paketës së aksioneve shtetërore Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit kërkon mendimin e organit të varësisë administrative.

4. Në qoftë se procedurat e llogaritjes së aksioneve të punonjësve të shoqërisë dhe të ish-pronarëve të truallit nuk realizohet, atëherë ministri i Ekonomisë Publike dhe Privatizimit nxjerr urdhërin për privatizimin e paketës së aksioneve të shoqërisë, pa u mohuar atyre të drejtën për aksione me një publikim të dytë.

5. Në shoqëritë tregtare, kur ka të dhëna të plota për pjesën e aksioneve për punonjësit e shoqërisë dhe për ish-pronarët e truallit, ministri i Ekonomisë Publike dhe Privatizimit ka të drejtë të përcaktojë paketën e aksioneve, që i ofrohet blerësit dhe nxjerr urdhërin përkatës për privatizim.

II. Procedurat për privatizimin e paketave të aksioneve

1. Brenda 10 ditëve nga marrja e urdhërit të ministrit (pika 3 e shkronjës “D”, kapitulli I) Agjencia Kombëtare e Privatizimit fillon procedurën e publikimit për shitjen e paketës së aksioneve që i ofrohet blerësit, duke publikuar shitjen e paketës së aksioneve. Afati i publikimit do të jetë 30 ditë. Brenda kësaj periudhe bëhet publikimi në tri gazeta me qarkullim kombëtar.

Brenda periudhës së publikimit në gazetatat me qarkullim kombëtar, Agjencia Kombëtare e Privatizimit vendos pranë shoqërive afishe, me të dhënat e publikuara për shoqëritë që privatizohen.

Në fund të periudhës së publikimit Agjencia Kombëtare e Privatizimit mban provesverbal për vendosjen pranë shoqërive të afisheve me të dhënat e publikuara.

Objekt publikimi do të jenë:

- Emri i shoqërisë;
- Selia;
- Kapitali themeltar dhe numri i aksioneve të shoqërisë;

- Paketa e aksioneve që privatizohen;
- Vlera e paketës së aksioneve;
- Objekti i veprimtarisë;
- Sipërfaqja e truallit të shoqërisë;
- Data, ora dhe vendi i zhvillimit të ankandit.

2. Pjesëmarrësit në ankand, gjatë periudhës së publikimit, kanë të drejtë të njihen me dosjen e shoqërisë, e cila ndodhet në Ministrinë e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, në Agjencinë Kombëtare të Privatizimit. Gjithashtu ata mund të marrin informacion në shoqërinë që privatizohen. Pjesëmarrja në ankand, pa u njohur me dosjen e shoqërisë, është në përgjegjësinë e subjekteve pjesëmarrëse.

A. Paketa e aksioneve që i ofrohet me ankand blerësit të vetëm

1. Paketa e aksioneve, që i ofrohet me ankand blerësit të vetëm, shitet në lekë.
2. Pjesëmarrësit në ankandin e paketës së aksioneve, të ofruar blerësit të vetëm për privatizim, paraqesin para komisionit të ankandit dokumentacionin e mëposhtëm:
 - Kërkesën me shkrim për pjesëmarrje në privatizimin e paketës së aksioneve të shoqërisë.
 - Dokumentet ligjore, identifikuese të personave fizikë ose juridikë.
 - Dokumentin bankar të pagesës paraprake me lekë mandatarkëtimin, urdhërxhirimin apo garancinë bankare në lekë për 30 përqindshin e vlerës së paketës së aksioneve, në favor të Agjencisë Kombëtare të Privatizimit.
3. Komisioni i ankandit përbëhet nga:

- | | |
|--|------------|
| 1. Përfaqësuesi i AKP-së | - kryetar |
| 2. Juristi i AKP-së | - anëtar |
| 3. Përfaqësuesi i Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit | - anëtar |
| 4. Përfaqësuesi i shoqërisë tregtare që privatizohet | - anëtar |
| 5. Përfaqësuesi i organit administrativ të linjës | - anëtar |
| 6. Punonjësi i AKP-së, pa të drejtë vote | - sekretar |

4. Titullarët e organeve të përmendura në pikën 3 të shkronjës A, në kapitullin II të këtij vendimi, ngarkohen me përgjegjësi për mospjesëmarrjen e anëtarëve të komisionit të ankandit në datën dhe në orën e caktuar për zhvillimin e ankandit.

5. Komisioni i ankandit merr vendime të vlefshme me votat e jo më pak se tre anëtarëve të vet. Kur nuk sigurohet pjesëmarrja e plotë e anëtarëve të komisionit, ankandi zhvillohet, por jo me më pak se tre anëtarë komisioni, me të drejtë vote. Në këtë rast vendimi i anëtarëve të komisionit duhet të jetë unanim. Kryetari ka të drejtën e dy votave, në rast barazimi votash.

6. Komisioni i ankandit ka këto detyra:

- Të regjistrojë dhe të identifikojë, sipas dokumenteve që kërkon ligji, dhe të nënshkruajë me secilin pjesëmarrës marrëveshjen për kushtet për privatizimin e paketës së aksioneve.
- Të paraqesë anëtarët e komisionit të pjesëmarrësit;
- Të deklarojë vlerën fillestare të ankandit;
- Të drejtojë marrjen e ofertave;
- Të hartojë dokumentacionin për ecurinë e ankandit, që përbëhet nga procesverbal dhe raporti për përfundimin e ankandit. Ky dokumentacion nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e komisionit të ankandit dhe nga fituesi i tij.

7. Fituesi i ankandit shpallet deklaruesi i çmimit më të lartë.

8. Ditën e ankandit fituesi merr nga Agjencia Kombëtare e Privatizimit autorizimin për pagesën e plotë të vlerës së paketës së aksioneve të publikuara për shitje, ku përcaktohen kushtet që duhen plotësuar nga pala blerëse para nënshkrimit të kontratës së shitjes. Në të përcaktohet se fituesi i ankandit është i detyruar të bëjë pagesën e plotë të vlerës së paketës së aksioneve brenda 30 ditëve nga data e zhvillimit të ankandit.

9. Pas lidhjes së kontratës pjesëmarrësve të tjerë u kthehet vlera fillestare, prej 30

përqindësh, e paguar paraprakisht për pjesëmarrje në ankand.

10. Fituesit të ankandit, që nuk kryen pagesën e plotë brenda afatit të përcaktuar në pikën 8 të këtij kapitulli, si dhe rastet kur ai tërhiqet brenda këtij afati, i mbahet vlera fillestare, e paguar paraprakisht për pjesëmarrje në ankand, si e ardhur në buxhet. Në vazhdim, procedura rifillon nga pika 1 e kapitullit II të këtij vendimi.

11. Vetëm kur blerësi plotëson kushtet e autorizimit sipas pikës 8, kapitulli II-a, Agjencia Kombëtare e Privatizimit lidh, me palën blerëse, kontratën e shitjes së paketës së aksioneve të shoqërisë së publikuar për shitje.

12. Në rast se në ankandin e shpallur nga Agjencia Kombëtare e Privatizimit nuk paraqitet asnjë pjesëmarrës, kjo agjenci njofton Ministrinë e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit dhe pret një urdhër të ri nga ministri i Ekonomisë Publike dhe Privatizimit për mënyrën e privatizimit të paketës së aksioneve.

B. Paketa e aksioneve për publikun

1. Shitja e paketës së aksioneve për publikun kryhet me ankand, me bono privatizimi dhe lekë privatizimi.

2. Procedurat e shitjes së paketës së aksioneve për publikun fillojnë me publikimin në tri gazeta me qarkullim kombëtar të paktën gjashtë herë. Brenda periudhës së publikimit në gazetat me qarkullim kombëtar, Agjencia Kombëtare e Privatizimit vendos afishe, me të dhënat e publikuara, në selinë e shoqërisë që privatizohet. Afati i publikimit zgjat jo më pak se 30 ditë.

3. Regjistrimi i porosive për aksione të shoqërisë, me bono dhe lekë privatizimi, zgjat jo më shumë se 45 ditë.

4. Personat, fizikë dhe juridikë, kanë të drejtë të porositin aksione për çdo shoqëri tregtare, të shpallur për shitje, njëkohësisht në të gjitha qendrat e ankandeve të Agjencisë Kombëtare të Privatizimit në rrethe, pavarësisht nga vendndodhja e shoqërisë tregtare.

5. Të paktën brenda 45 ditëve nga data e mbylljes së ankandit, Agjencia Kombëtare e Privatizimit përpunon dhe nxjerr rezultatin përfundimtar për secilin pjesëmarrës në ankand. Mënyra e shpërndarjes së kapitalit të paketës së aksioneve për publikun do të jetë në përpjesëtim, sipas rezultateve përfundimtare të raportit kërkesë-ofertë.

6. Përfundimi i periudhës së regjistrimit shënon edhe përfundimin e privatizimit të paketës së aksioneve për publikun.

C. Privatizimi i paketës së aksioneve shtetërore në shoqëritë pjesërisht të privatizuara

1. Në shoqëritë, ku paketa shtetërore është nën 50 për qind të aksioneve, në bazë të dokumentacionit që ka AKP-ja, pasi të jetë zbritur përqindja e aksioneve për ish-pronarët e truallit dhe për punonjësit e shoqërisë, shitja e pjesës së mbetur të paketës së aksioneve, në favor të aksionerëve të shoqërisë, bëhet me përcaktimin e vlerës së tregut të paketës së aksioneve me ankand.

2. Me mbërritjen e urdhrat të ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, i cili shoqërohet edhe nga lista e aksionerëve të shoqërisë, me adresat përkatëse. Agjencia Kombëtare e Privatizimit fillon dhe zbaton procedurat e privatizimit, sipas pikave 1,2 të kapitullit II, dhe sipas pikave 1,2,3,4,5,6 të shkronjës A të këtij vendimi.

3. Ofertë fituese shpallet oferta që deklaron çmimin më të lartë. Kjo ofertë, brenda 10 ditëve, i ofrohet aksionerëve të shoqërisë, të cilët duhet të japin pëlqimin për blerje, të shoqëruar me pagesën e plotë të vlerës së paketës së aksioneve, të arritur në ankandin e zhvilluar. Pagesa duhet të bëhet brenda 40 ditëve nga data e zhvillimit të ankandit.

4. Kur aksionerët e shoqërisë, të cilëve u është ofruar për blerje paketa e aksioneve, nuk japin pëlqimin për blerje dhe nuk kryejnë pagesën përkatëse brenda 10 ditëve, atëherë njoftohet pjesëmarrësi që ka ofruar çmimin më të lartë të paketës së aksioneve në ankandin e zhvilluar, duke lëshuar autorizimin përkatës për pagesën e vlerës së plotë të paketës së aksioneve.

Kjo pagesë duhet të kryhet brenda 30 ditëve nga data e lëshimit të autorizimit nga Agjencia Kombëtare e Privatizimit.

5. Kur pjesëmarrësi në ankand, i cili ka ofruar çmimin më të lartë të paketës së aksioneve, nuk kryen pagesën sipas paragrafit të dytë të pikës 4, të shkronjës "C", atëhere vlera prej 30 përqindësh, e paguar paraprakisht prej tij, mbahet si e ardhur në buxhet.

6. Në këtë rast, pjesa e mbetur e paketës së aksioneve u ofrohet pjesëmarrësve në ankand sipas radhës. Kur nuk ka oferta të tjera, atëhere ajo u ofrohet aksionerëve të shoqërisë pa ankand.

7. Brenda 5 ditëve nga mbërritja e urdhërit të ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Agjencia Kombëtare e Privatizimit fton aksionerët e shoqërisë të paraqiten për fillimin e procedurave të privatizimit. Aksionerët e shoqërisë duhet të paraqiten në Agjencinë Kombëtare të Privatizimit brenda 30 ditëve nga data e njoftimit.

8. Kur aksionerët e shoqërisë nuk paraqiten brenda këtij afati ose nuk pranojnë blerjen e paketës, Agjencia Kombëtare e Privatizimit njofton Ministrinë e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit dhe pret urdhrin përkatës të ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit për mënyrën e privatizimit të pjesës së mbetur të aksioneve në shoqërinë përkatëse.

9. Aksionerët e shoqërisë, për fillimin e procedurave të privatizimit, duhet të paraqesin në Agjencinë Kombëtare të Privatizimit këto dokumente:

a. Kërkesën me shkrim, ku të shprehin pëlqimin për blerjen e pjesës së mbetur të aksioneve që u janë ofruar për blerje;

b. Pagesën paraprake, mandatarkëtimin, urdhërshkrimin apo garancinë bankare në lekë për 30 përqindëshin e vlerës së pjesës së mbetur të aksioneve, që u janë ofruar për blerje, në favor të Agjencisë Kombëtare të Privatizimit;

c. Një fotokopje të noterizuar të dokumentit identifikues.

Kur aksionerët e shoqërisë kanë plotësuar kërkesat e mësipërme, Agjencia Kombëtare e Privatizimit lëshon autorizimin për kryerjen e pagesës së plotë të vlerës së pjesës së mbetur të aksioneve që u janë ofruar për blerje.

Në autorizim përcaktohet se nëse aksionerët e shoqërisë nuk bëjnë pagesën e plotë të pjesës së mbetur të vlerës së aksioneve që u janë ofruar për blerje brenda 30 ditësh nga data e lëshimit të autorizimit, atëhere mbahet vlera e paguar paraprakisht prej tyre, 30 përqind, e cila kalon në favor të buxhetit të shtetit. Për llogari të AKP-së kalon 5 përqind e vlerës së plotë të pjesës së mbetur të aksioneve, që përcaktohet në urdhrin përkatës të ministrit të Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit. Edhe në rastet kur nuk kryhet pagesa e plotë nga aksionerët e shoqërisë, në favor të AKP-së kalon vlera prej 5 përqindësh nga vlera 30 përqind e paguar paraprakisht prej tyre.

Për shoqëritë pjesërisht të privatizuara, kapitali i të cilave gjatë kësaj kohe ka pësuar ndryshime, llogaritja e aksioneve për punonjësit e shoqërisë dhe ish-pronarët e truallit do të bëhen duke iu referuar kapitalit themeltar, të regjistruar në gjykatë, me të cilin ka filluar procedura e privatizimit të shoqërisë.

III. Të përgjithshme

1. Rezultatet përfundimtare, të ankandit hartohen nga Agjencia Kombëtare e Privatizimit në katër kopje, tre prej të cilave u përcillen:

- Shoqërisë tregtare të privatizuar;
- Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit
- Qendrës së regjistrimit të aksioneve.
- Kopja e katërt ruhet në Agjencinë Kombëtare të Privatizimit

2. Vlera e llogaritur e një aksioni caktohet e tillë që të zvogëlojë, në minimumin e mundshëm, efektet e rrumbullakimeve të përqindjeve. Mbetjet e mundshme nga rrumbullakimet kalojnë në llogaritë e shoqërisë, në zmadhim ose në zvogëlim të rezervës nga rivlerësimi.

3. Agjencia Kombëtare e Privatizimit harton raportin përfundimtar për strukturën e pronësisë së aksioneve dhe materialin origjinal e dërgon në Ministrinë e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit.

4. Lista e aksionerëve nuk publikohet. Çdo aksioner ka të drejtë të njihet me këtë listë pranë shoqërisë përkatëse dhe në rast paqartësie, mund të kërkojë sqarime pranë Agjencisë

Kombëtare të Privatizimit.

5. Gjatë periudhës pas ankandit deri në mbledhjen e parë të asamblesë është i ndaluar çdo emëtim dytësor i aksioneve nga ana e shoqërisë.

6. Gjatë kësaj periudhe nuk lejohet asnjë strukturim i kapitalit ekzistues.

7. Deri në zgjedhjen e organeve të reja të shoqërisë së privatizuar dhe kryerjes së ndryshimeve përkatëse të statutit, këshilli mbikëqyrës dhe drejtori i përgjithshëm i shoqërisë shtetërore do të vazhdojnë të kryejnë funksionet e tyre dhe do të mbajnë përgjegjësi të plotë për administrimin e pasurisë e të veprimtarisë së shoqërisë.

8. Deri në zgjedhjen e organeve të reja të shoqërisë së privatizuar dhe hyrjen në funksion të këtyre organeve, as shoqëria dhe as ndonjë organ tjetër nuk kanë të drejtë të kryejnë ose të autorizojnë kryerjen e veprimtarive të mëposhtme:

- Shitjen e aktiveve të qëndrueshme të shoqërisë;
- Kryerjen e investimeve të tjera, përveç atyre që kanë qenë kontraktuar më parë;
- Marrjen ose dhënien me qira të objekteve të ndryshme;
- Marrjen e huave, përveç atyre që kanë qenë kontraktuar më parë, për nevoja rrjedhëse të veprimtarisë së shoqërisë;
- Çdo veprim tjetër, që do të sillte pakësimin e aktivitetit neto të shoqërisë.

Gjatë kësaj periudhe shoqëria nuk ka të drejtë, gjithashtu, të kryejë riorganizime, që sjellin shkurtime në numrin e punonjësve.

9. Shoqëria përgatit gjendjen financiare, për periudhën nga çelja e ushtrimit deri në datën e fundit të muajit kur është shpallur rezultati përfundimtar i ankandit, sipas akteve ligjore në fuqi.

10. Shoqëria shtetërore e privatizuar do të vazhdojë të mbartë të gjitha detyrimet, kreditore dhe debitoare, të pasqyruara në bilancin e paraqitur të shoqërisë.

11. Procedurat e zhvillimit të mbledhjeve të asamblesë së shoqërive anonime u duhen referuar ligjit nr.7638, datë 19.11.1992, "Për shoqëritë tregtare".

12. Shoqëritë anonime, të krijuara me kapital të përbashkët, do të trajtohen sipas vendimit nr.230, datë 4.4.1998, të Këshillit të Ministrave, "Për privatizimin e pjesëve të kapitalit të zotëruar nga shteti, në shoqëritë me kapital të përbashkët".

13. Vendimet nr.244, datë 25.5.1995, nr.608, datë 30.10.1995, nr.759, datë 11.11.1996, nr.760, datë 11.11.1996, nr.837, datë 9.12.1996, nr.446, datë 9.7.1998, nr.486, datë 28.10.1999, nr.24, datë 21.1.1999, nr.328, datë 12.7.1999, të Këshillit të Ministrave, shfuqizohen.

Për aktet ligjore e nënligjore, ku gjejnë zbatim vendimet e mësipërme, zbatohet ky vendim.

14. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit dhe Agjencia Kombëtare e Privatizimit të nxjerrin udhëzimin përkatës, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta